

ZAMIRA (METAJ) ALIMEMAJ

**VLERA KULTURORE E GJUHËSORE TË SHPREHURA NË  
KANUNIN E LABËRISË**

**Përmbledhje**

Kanuni i Labërisë, ashtu si dhe kanunet e tjerë shqiptarë, merr një rëndësi të veçantë për shkencat albanologjike, sepse ai ka të bëjë me lashtësinë e gjuhës e të kulturës sonë popullore, me shtrirjen hapësinore, me marrëdhëniet demografike, gjuhësore e kulturore të popullit të kësaj krahine me krahinat e tjera e më gjerë si dhe me rolin që ka luajtur, qysh në lashtësi, në trevat ku kanë jetuar të parët tanë. Normat e këtij Kanuni nuk mund të studiohen vetëm nga këndvështrimi historiko-etnologjik por edhe në aspektin gjuhësor. Në Kanunin e Labërisë pasuria gjuhësore e shqipes është shpalosur në tërë gjerësinë dhe thellësinë e saj. Forca e fjalës në këtë Kanun është mahnitëse. Aty gjejmë të ruajtura trajtat origjinale të fjalëve si dhe fjalë të formuara enkas, duke u dhënë gjuhëtarëve lëndën e parë për punime e studime të mëtejshme.

**Fjalë kyçe:** fjalëformim, lashtësi, kulturë, gjuhësore, argumentim, e arsyetuar

**Hyrje**

E drejta zakonore është anonime. Normat e saj, duke mos qenë asnjëherë të shkruara, u formuan në praktikë gjatë shekujve, atje ku kryheshin veprime e merreshin vendime. Zbatimi i tyre u përsërit për një kohë të gjatë, duke zëvendësuar e reja të vjetrën, në përputhje të plotë me zhvillimin e jetës dhe të shoqërisë<sup>1</sup>.

Vendosja e normave lindi si një nevojë historike, shoqërore, ekonomike e jetësore për të diktuar zakone e rregulla për parime të larta të moralit, duke shërbyer kështu, si një rregullator në funksion të rendit shoqëror. Kanuni i Labërisë konsiderohet si një sistem vlerash, karakteristike për një shoqëri pagane, në shtratin kulturor të së cilës lind e zhvillohet një shoqëri pa autoritet shtetëror, me etikë e rend shoqëror të vetin. Sistemi i vlerave të Kanunit përbëhet nga nderi, betimi, besa, miku-zot, hakmarrja.

Origjina e normave të Kanunit të Labërisë i përket lashtësisë, para pushtimit romak, që nga ilirët (shek. IV-I p.e.r.)<sup>2</sup> Normat e Kanunit janë zhvilluar në përputhje me kërkesat objektive të zhvillimit ekonomiko-shoqëror

---

<sup>1</sup> I. Hoxha, *Mbi disa aspekte të Kanunit të Lekë Dukagjinit*, "Kultura popullore" 2/1984, f. 175.

<sup>2</sup> I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*, Tiranë, 2006, f. 14.

e kulturor të krahinës së Labërisë. Kanuni i Labërisë ka tërhequr edhe vëmendjen e studiuesve të huaj. Kështu, shtegtarë anglezë që kanë vizituar Himarën në shek. XVII, K. Liku, E. Liri, J. Hobhaus etj., shkruajnë për një kod zakonor të fortë që vepronte në Himarë.<sup>3</sup> Burimet arkivore mungojnë por normat e Kanunit të Labërisë kanë vepruar gjatë shekujve. Përsa i përket prejardhjes së termit “Kanun”, ka mendime të ndryshme. At Gjergj Fishta mendon se “rrjedh nga greqishtja e vjetër, “kanon”, që u përhap edhe në gjuhë të tjera.”<sup>4</sup> Historiani Kristo Frashëri mendon se termi “kanun” është me origjinë bizantine dhe rrjedh nga “kanon”. Autorë të tjerë thonë se në Shqipëri ky term hyri nëpërmjet turqishtes “kanun” e “kanunname.”<sup>5</sup> Termi “kanon” është përdorur nga qeveria e Vlorës në aktin e quajtur “Kanoni i Zhurisë”, por në popull përdorehin fjalët: *shart, adet, zakon*. Kanuni i Labërisë, ashtu si dhe kanunet e tjerë shqiptarë, merr një rëndësi të veçantë për shkencat albanologjike sepse ai ka të bëjë me lashtësinë e gjuhës e të kulturës sonë popullore, me shtrirjen hapësinore, me marrëdhëniet demografike, gjuhësore e kulturore të popullit të kësaj krahine me krahinat e tjera e më gjerë si dhe me rolin që ka luajtur, qysh në lashtësi, në trevat ku kanë jetuar të parët tanë.

#### **Pasuria gjuhësore në “Kanunin e Labërisë”**

Në Kanunin e Labërisë pasuria gjuhësore e shqipes është shpalosur në tërë gjerësinë dhe thellësinë e saj. Gjuha shqipe paraqitet e përkryer e në të njëjtën kohë e ndërtaur thjesht, e aftë për të shprehur në mënyrë të plotë norma morale e juridike që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Është edhe merita e autorit I. Elezaj, që një pjesë të përmbledhjes e ka dhënë duke ruajtur të paprekur formulimin e vetë vendësve.

Në Labëri shumë shprehje të këtij Kanuni janë kthyer në sentenca jo vetëm tejet të sakta, po shpesh edhe të argumentuara e disa herë të dhëna edhe me ngjyrimë artistike. Fjala në Kanunin e Labërisë është si një “gur i çmuar”, që nuk hidhet në mënyrë të “pa kontrolluar”. Prandaj duhet të jesh i matur sepse fjala, është e përdorur mirë dhe në vendin e duhur dhe të orienton si, dhe nga të ecësh. Në këtë mënyrë ajo kthehet në një mjet të fuqishëm ekzekutiv. Forca e fjalës në këtë Kanun është mahnitëse. S’ka asgjë mangët e asgjë tepër. Ka një kursim të tejskajshëm të saj në një ndërtim konciz të përkryer e për t’u pasur zili. Idiomat këtu kthehen në aksioma, të cilat pranohen pa diskutim. “I miri dhe i keqi peshojnë 400 derhem”<sup>6</sup>, “Më mirë i vdekur e me nder, sesa i gjallë e i turpëruar”, “Vdekja me nder është kapak floriri”<sup>7</sup>, “Besa e burrit -

<sup>3</sup> R. Memushaj, *Himara*, Tiranë, 2004, f. 15.

<sup>4</sup> *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Parathënia.

<sup>5</sup> I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*, Tiranë, 2006, f. 24.

<sup>6</sup> I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*, Neni 21.

<sup>7</sup> Po aty, Neni 24.

pesha e gurit”, “Kau lidhet për brirësh, burri për fjale”, “Nga del shpirti, del fjala”<sup>8</sup>, “Ngordhi kau, u prish penda”<sup>9</sup>.

Një vend të konsiderueshëm zënë normat e kuvendeve të burrave, për të cilat mund të themi se ato në Labëri shërbenin si një vend ku, nëpërmjet gjuhës dhe vlerës kulturore të saj si mjet i realizimit të një personaliteti të lartë, përgatiteshin figura të shquara që spikatnin për virtytet e larta, urtësinë, thjeshtësinë dhe forcën e fjalës. Populli i kësaj krahine, me anën e fjalëve të urta dhe të bisedave në odat e burrave apo në kuvende, ka sintetizuar jo vetëm urtësinë, por edhe thjeshtësinë, modestinë, si dhe rolin e fjalës si mjet ndikues në shoqëri.

Mençuria popullore e viseve shqiptare nëpërmjet thënieve diturake që ndjellin harmoni e pajtim, si dhe me anë të aq shumë fjalësh të urta e këshillash për të parapëlqyer gjakftohtësinë ndaj rrëmbimit, qetësinë dhe maturinë ndaj shpërthimit të menjëhershëm, jo vetëm kritikon, por edhe tregon udhën e drejtë që duhet ndjekur në jetë, prandaj, të shumtën e herës, fjalët e urta kanë karakter gjykimesh të padiskutueshme, me vlerë të përhershme; ato formulohen si udhëzime e parime morale të mirëqena.<sup>10</sup>

Le të përmendim ndonjë prej tyre: “Fajin e ka gjuha, belanë e pëson koka”, “Bie një fjalë e nxjerrë një mijë”, “Fjala ndreq, fjala vret”, “Fjala e mire, çel derën e hekurt”, “Gjuha pret hekur”. Të përkryera paraqiten normat e arsyetuara. Së pari jepet në mënyrë tepër koncize veprimi a fakti; më pas edhe argumentimi i domosdoshmërisë së kryerjes së tij. “Vjedhja e shtëpisë është vjedhje e rëndë, sepse veç dëmit i shkaktohet edhe fyerje të zotit të shtëpisë: “Sot hyn në shtëpi për të vjedhur, nesër për gruan”<sup>11</sup>. Mashtrimi ndaj burrit ose gruas madhore nuk dënohet penalisht, sepse vepron rregulli: “sytë në ballë i ke, mendjen në kokë, mos u gënje, hapi sytë para se të japësh ose të marrësh gjë”<sup>12</sup>, “Mikpritësit shikoi vetullat e jo petullat”<sup>13</sup>. Disa nene shprehen me një mendim të prerë. Ata janë tepër të qarta, prandaj kërkojnë zbatim pa mëdyshje. “Vatër e shtëpi – mik e mirësi”<sup>14</sup>, “Po dhe fjalën-mbaje”<sup>15</sup>, “Miku është i paprekshëm”<sup>16</sup>.

#### **Ndërtimet sintaksore në “Kanuni i Labërisë”**

Fjalitë eliptike me ndërtime tejet lakonike, do të mbeten si kryevepra të vërteta të sintaksës popullore, ende e studiuar fare pak. Po marrim një

<sup>8</sup> Po aty, Neni 29.

<sup>9</sup> Po aty, Neni 223.

<sup>10</sup> Gj. Shkurtaç, *Emografia e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 94.

<sup>11</sup> I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*, Neni 726.

<sup>12</sup> Po aty, Neni 755.

<sup>13</sup> Po aty, Neni 43.

<sup>14</sup> Po aty, Neni 42.

<sup>15</sup> Po aty, Neni 29.

<sup>16</sup> Po aty, Neni 43.

shembull: “fshat e zanat, shtëpi e nasihat”. Në këto dy fjali mungon kallëzuesi, sepse në këto raste kallëzuesi del i tepërt dhe prej saj janë ndërtuar shprehjet proverbiale si: “Sipas vendit bëhet dhe kuvendi”, apo “Sipas kokës edhe festja”.

Ndërtimet sintaksore në Kanun vlejné për t’u bërë objekt diskutimi. Shumë këndshëm janë përdorur fjali me numër të paktë fjalësh, ku mungon kallëzuesi, por që mund të konsiderohen si perla gjuhësore, sepse mendimi dhe fjala përputhen përsosmërisht. Për shembull: “Marrja e nuses-çështje zakoni e nderi”, “Vatër e shtëpi-mik e mirësi”, “Besa e burrit-pesha e gurit”, “Krushku-krushk, miku-mik” (Krushku nuk barazohet me mikun). Në këto fjali mungon kallëzuesi, sepse në këto raste kallëzuesi del i tepërt. Përpjekja për të dhënë një mendim sa më të saktë, zakonisht shoqërohet edhe me nevojën e krijimit të fjalëve të reja e të kuptimeve të reja, si edhe me formime të ndryshme para e prapashtesore. Në këtë drejtim Kanuni i Labërisë është minierë e pafund.

Pasuria e madhe e kompozicionit e deri te përngjitjet, tregon se populli i krahinës së Labërisë e ka kërkuar fjalën dhe ka arritur ta ndërtojë në natyrën e së folmes së vet. Krahas kompozitave si: *babëzoti, mëmëzonja, kryekrushku, hakmarrje, gjakmarrje, fatkeqësi, farefis* etj., gjejmë të përdorura edhe fjalë të formuara me parashtesa apo prapashtesa si p.sh.: *pritësi, pabesi, hasmëri, moszbatim, krahinor* etj. Shumë prej fjalëve të formuara i gjejmë të përdorura këndshëm në kombinime të ndryshme fjalësh. Kështu për shembull fjala *gjëri*, e prejardhur nga *gjë* (*Jemi gjë / gjëri me të?*) përdoret për të treguar lidhje farefisnore. Fjala *fare* e *fis* janë sinonime dhe përdoren në shprehjet si: *Jemi një fis e një sua*, apo *Jemi një fis e një farë*. Dihet që kompozicioni shpreh gjithnjë vitalitetin e një gjuhe.

### Neologjizmat

Neologjizmat në Kanun janë të shumta e mbi të gjitha të ndërtuara bukur p.sh. *vëllamëria, motërma, këpucëgrisuri, qinosar* (nga qinosi), *kanosjer* (nga kanos), *betar* (nga bëj be), *gjobtar* (vendos gjoba). Në Kanun gjejmë një numër të madh fjalësh të rralla si: *bekshi* (roje), *nome* (stan), *kanusia* (gjoba), *savan* (qefin), *mera* (kullota), *qinosar* (çoban), *kseniti* (dëbim), *mesit* (ndërmjetës) etj. Huazimet në Kanun nuk janë të shumta, gjë që flet në të mirë të autenticitetit të tij. Për shembull fjala *kuvend*, ndonëse është huazuar nga latinishtja *conventum*, është nga fjalët më të ngulitura e që është rrënjëzuar së hershmi në shqipen, duke u bërë edhe nga më të pëlleshmet në çerdhëzimet e formuara prej saj, si foljet *kuvendoj, hyj në kuvend, hap kuvendin, lidh kuvend, çel kuvend, shtroj kuvend, mbyll kuvendin* etj. pastaj, fjalëformimet e shumta atributive si: *kuvendëmbël, kuvendues, kuvendshtruar* etj.

Normat e këtij kanuni shprehin vlera të mëdha kulturore e gjuhësore të popullit të kësaj krahine. Me një gjuhë e ligjëratë të pasur e të zhdërvjelltë, ato shprehin urtësinë, mençurinë dhe dijen, si dhe veprimtarinë e gjallë e të

larmishme të popullit të kësaj krahine në çdo fushë të jetës. Mendimi dhe forma e shprehjes shkojnë paralel në unitet me njëra-tjetrën.

Kemi përzgjedhur disa njësi gjuhësore, kryesisht sintagma (grupe e togje fjalësh) të cilat paraqesin një interes të veçantë nga kuptimi e forma e tyre. Familja, si një organizim i caktuar i jetës dhe i veprimtarisë shoqërore, ka zënë një vend të veçantë e të rëndësishëm ndër kanunet tona. Terminologjia e përdorur në kanun është shumë e pasur e në sfond ka kulturën e popullit të kësaj krahine. Në një vështrim të gjerë mund të themi se në familje hyjnë: vëllazëria, farefisi, njerëz të lidhur me anë të martesës, krushqitë etj. Nga ana gjuhësore këtu ndeshim terma të tillë si: *sëmerja* (gruaja e dytë e burrit që bashkëjeton edhe me të parën), *thjeshtri*, *thjeshtra* (djali ose vajza e gruas me burrin e parë që e sjell me vete kur martohet me burrin e dytë), *vëllam* ose *byrazer* (kur një person pi gjakun e një personi tjetër dhe bëhen si vëllazër), *babëzoti*, *nikoqirja*, *lajmës* etj.

a) Sintagma që duhen shpjeguar: plaku i barkut (i madhi i fisit), fëmija për shpirt (birësim), zënie nuse (kërkesë për fejesë)

b) Sintagma me kuptim të qartë (burra zakoni, zonjë shtëpie, breza nga trangu i babës, fis i largët, martesë me dy gra, martesë me rrëmbim). Fjala fis përdoret për të treguar përkatësinë në të njëjtën gjini, si “*Jemi një fis*”, apo për të treguar prejardhjen nga një familje e dëgjuar për trimëri dhe ndershmëri, si “*Është nga fis i mirë*”. Sintagma *farë* e *fis* përdoret në shprehjet si: *Jemi fare e fis*. *Jemi një fis e një sua*, apo *Jemi një fis e një farë*.

Kulti i nderit vjen nga kohëra shumë të hershme përmes kanunit. Nderi dhe dinjiteti personal në Labëri, ashtu si në të gjitha vendet ku banojnë shqiptarë, është ndër vlerat më të larta shoqërore, sepse “Turpi është më i rëndë se vdekja” dhe “S’hahen bashkë turp e bukë”. Nderi është personal. Çdo njeri e ka nderin për vete dhe nuk mund të preket nga askush në nder. Bëhet fjalë për një nder të ashpër por dinjitoz e madhështor në ashpërsinë e tij që ndryshon nga kodet e kalorësisë europiane.

Nderi në Kanun nuk është thjesht një kategori morale por një vlerë shoqërore për çdo njeri, të varfër e të pasur. Nderi si një nga cilësitë e veçanta të karakterit të labit, ka zënë vend në normat e kanunit, përmes të cilave janë zgjidhur shumë situata dhe është vënë në vend nderi i burrit dhe i gruas. Nderi nuk del vetëm në planin personal por edhe në planin shoqëror dhe ndërtimi i këtyre neneve me një gjuhë të thjeshtë e të pasur kanë lehtësuar kuptimin dhe zbatimin e tyre duke ruajtur ekuilibrat e nevojshëm të jetës së popullit të zonës.

Zhvillimet e brendshme nga njëra anë dhe kontaktet historike e ndikimet kulturore të të huajve kanë sjellë ndryshime në kulturën shpirtërore e materiale të shqiptarëve.

Më qartë gjurmët e ndryshimeve duken në fushën e gjuhës. Kështu leksiku i përgjithshëm nga njëra anë ka humbur fjalë të vjetra të shqipes, por nga ana tjetër është pasuruar me fjalë të reja, një pjesë e të cilave janë të huaja.

Njëlloj është prekur ajo pjesë e trashëgimisë kulturore që përcillet nëpërmjet gjuhës. Ndikimet kulturore të huaja mbi kulturën vendëse kanë qenë të atilla që kurrsesi nuk mund të injorohen për një zonë si Labëria.

Me këto ndryshime shpjegohen ndryshimet në inventarin leksikor dhe të emërtimeve të njerëzve e të vendeve si rrjedhim i zëvendësimit të shumë fjalëve e emërtimeve shqipe me njësi greke dhe latine, sllave apo turke. Elementet prej këtyre gjuhëve formojnë disa shtresa kulturore në shqipen, të cilat mund të veçohen pa vështirësi.

Megjithëse leksiku në vite është përpunuar për një fushë të caktuar, ndonëse me përdorim të rrallë, në Kanunin e Labërisë ka përdorime të fjalëve me kuptim të figurshëm, duke i mbishtuar edhe ngjyime keqësuese p.sh. *“Femra e turpëruar gorrromiset (d.m.th., vritet) me gjithë fëmijën në bark. Për çështje morali kur një çift zihej në flagrancë rregulla e përgjithshme ishte që në këtë rast vritej “si qeni dhe bushtra dhe gjaku i tyre nuk lahej”.*

Shpjegimi i fjalëve realizohet me shumë kujdes sipas shkallës dhe emërtimeve të realizuar në vite për një fushë të caktuar leksikore.

1. *“Kobar është- kusar, vjedhës pulash i paarmatosur, i përbuzur e i përçmuar-njëri i sharë.*

2. *Kusar (vjedhës) që vjedh vetëm fshehurazi një sheleg dhi dhe i humb gjurmët.*

3. *Hajdut –( ai që merret me vjedhje) vetëm ose në bashkëpunim me të tjerët.*

4. *Pretor- quhet ai që krijon dhe drejton çetën e pretorëve për të kryer haptazi vjedhje të pasurisë<sup>17</sup>*

Disa mjete të leksikut të përgjithshëm pësojnë ndryshime sidomos në përdorimet edhe si ndikim nga gjuhët e huaja, por edhe nga përpjekjet për shqipërim të një rregulli të përshtatur me kohën dhe me situatën. Pjesa më e veçantë e fjalëve janë emërtesa për sende, procese, detyra të personave përkatës etj. Në krye të fjalisë del një fjalë emërtuese pastaj shoqërohet me fjalët që e shpjegon ose e individualizon.

*Zonjë shtëpie* (mëmëzote, mëmëzonjë) quhet gruaja e të zotit të shtëpisë, si rregull gruaja më e moshuar, më e afta për të drejtuar, administruar (nikoqire) për punët e brendshme të shtëpisë dhe e drejtë.

*Gruaja është çelësi i gjithçkaje në shtëpi.*

*Kryefamiljari (babëzoti) ruan nderin e shtëpisë.*

*Kumtri quhet ai që ka për detyrë të vijë dhe të hedhë ujë me ibrik në varr të atij që vdes*

*Kumtri konsiderohet mik i shtëpisë e nuk mund të bëhet krushqi me të.*

<sup>17</sup> I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*. Tiranë, 2006, f. 236.

*Trashëgimia është kalimi pa shpërblim i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe i të drejtave pas vdekjes së trashëgimlënësit te trashëgimtari, brenda barkut duke u bërë zot malli.*

*Dëbimi në një fshat tjetër quhej kseneti, ishte një ndër dënimet më të rënda.”<sup>18</sup>*

Leksiku pasurohet me formime të fjalëve të reja: *babëzoti mëmëzote, mëmëzonjë, këpucëgrisur, dorëras* etj.

Ndryshimi i dendurisë së disa fjalëve, shoqërohet me krijimin i sintagmave emërore të thjeshta dhe të zgjeruara me lidhje specifike bashkë me disa zhvendosje të kuptimeve në kohë: *vëllam qumështi, gjakësi e babës, breza nga tringu i babës, breza nga tringu i nënës, breza në vijë të tërthortë, gjinia e gruas së martuar, fëmija për shpirt, fëmijët e gruas me burrin e parë të vdekur, burra me numër tek, të zgjedhur, të mençur dhe trima, burrë i zoti, i zgjuar, njohës i zakoneve, martesë bashkëgjakëse (consaguine) kafshë të vërteta ngarkese, të marrët e flokëve, të lidhurit me kumbari, zënie nuse, prerjen me gërshërë e një tufe të vogël flokësh, kumbara e flokëve të djalit, kujdestari i vajzës jetime, ikja e gruas së martuar nga burri, martesë me kurorë, martesë me shpërblim, martesë me grabitje (rrëmbimet), ca zakone të liga e barbare etj.*

#### **Tipare morfologjike**

Dallesa më e gjerë shihet në fushën e morfologjisë. Koha e tashme e mënyrës dëftore përdoret me një kuptim mbarë kohor. Kjo kohë ndoshta është zgjedhur për shumë arsye. Mendojmë që përdorimi për t'i dhënë kumtimin vlerën e një pohimi të përhershëm është arsyeja kryesore. Shkrimi i kanunit në rrjedhë të shekujve ka bërë që më shumë të kemi përdorimin e kohës së tashme me kuptimin e së shkuarës, kur duam ta paraqesim si të gjallë një veprim që ka marrë fund në të shkuarën, sikur të ndodhë para syve tanë (e tashme historike)<sup>19</sup>, koha e tashme si folje drejtuese në fjalinë kryesore nënrendit fjali të varura me folje në kohë të ndryshme duke shprehur marrëdhënie kushtëzuese, përcaktore, kohore etj.

Trajtat kohore të kohës së tashme janë ato që lidhen me aksione të njëpasnjëshme në veprimet që ndjekin njëri-tjetrin, që lidhet me përparimin, vetëqeverisjen e plotësimin e detyrimeve në fshat dhe në familje. Zakonisht pas foljes në kohën e tashme të dëftores vendosen gjymtyrë si kundrina apo dhe rrethanorë duke formuar një sintagmë (*detyron familjen, ndihmojnë djalin, jep babait, drejton në odat, arrijnë në oborr, hyn në odën e nuses, i fusin në një mur*).

Kryesisht folja është në diatezën veprorë: *përmban, jeton, bëjnë, gëzon, punojnë, banojnë, ruan, rri, zë, jep, pret, përcjell, pyet, dorëzojnë, vepron,*

<sup>18</sup> I. Elezi, po aty, f. 75, 78, 193.

<sup>19</sup> B. Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 107.

*përfaqëson, rrit, edukon, gëzon, ndan, dërgon, përfaqëson, jep, blen, lejon, qorton, këshillon, bëjnë, siguron, blen, merr, trajton, bëjnë, vepron, bën, pret, përcejell, përfaqëson, mban, siguron, mbajnë, shesin, ndërrojnë, lënë, kërkojnë, shfaqin, drejton, mban, sheh, shkon, jetojnë, flenë, nderojnë.*

Foljet në kohën e tashme në diatezën pësore shoqërohen me kundrina të zhdrejta me parafjalë: *bëhet me një fis tjetër, barazohet me mikun, ndahen për gojë, shkon për gisht, ndjek gjaksin; nga gjymtyrë të tjera si përcaktor kallëzuesor: (quhen motër e vëlla): kuptohet, dallohet, formohet, përbëhen, shpallet, lejohen, dëgjohet, zgjidhet, kujdeset, përgjigjet, zëndësohet, dallohet, bëhet, thirret, quhet, binden, bëhet, martohen, urdhërohen, vendosen, ndahen, bashkohen, shkrihen, etj. kthehet, ndërrohet, nxen.*

Trajtat kohore të së kryerës së thjeshtë kanë përdorim të paktë lidhet me përfundimin e veprimeve: *ikën nga burri, ngordhi kau, u prish parmenda*<sup>20</sup>.

Foljet që përdoren në të kryerën e mënyrës dëftore krahas përfundimit të veprimit, ligjëruesi vë në dukje edhe pasojat<sup>21</sup>. Mund të tregojë pikënisjen e veprimit ose gjithë kohën që nga fillimi i veprimit e gjer në çastin e ligjërimin. Herë-herë përdoret me kuptimin e së ardhmes, kur në fjalinë kryesore folësi, shkruesi e paraqet si një fakt të kryer një veprim që do të nisë: *ka turpëruar, ka bërë, kanë pirë (qumësht, gjak), ka mbushur, është thirrë, kanë vënë (djemtë) ka sjellë (nusja).*

Shtrirje të gjerë ka edhe përdorimi i kohës së tashme të mënyrës lidhore, veta e tretë, për të treguar një veprim kryerjen e të cilit, folësi shkruesi, e paraqet si të mundshme a të dëshirueshme. Në fjalitë e varura folja në kohën e tashme të mënyrës lidhore përforcohet duke vendosur para saj foljen me vlerë modale *mund*<sup>22</sup> *të jetojnë, të nderojnë, të shkojnë, të binden, të mbajnë, të dallohet, të zgjedhë, të bëjnë, të drejtojnë, të shpërdorohen, të presë, të dëbojë, të marrë, të japë (të bëhet lajmëse) të shesin, të blejnë, të ndajnë, të ndahet, të krijojnë, të pranohen, të bashkohen, të bojkotojnë, të dëbojë, të birësojë, të njohin, të qëndrojnë, të bëhen etj.*

*“Burri që ka fëmijë të tij nuk mund të birësojë fëmijë të gjetur. Vëllamë mund të bëhen edhe ata që kanë pirë qumësht nga gjiri i një nëne, për shkak se nëna e tjetrit ka vdekur”*<sup>23</sup>.

Krahas mënyrës lidhore përdoret e alternuar edhe mënyra dëshirore: *trashëgofshin, qoftë, shpërblefsha, rrofsh, martofsh, u ardhsha, të dhashtë.*

<sup>20</sup> D. Klosi, N. Merkuri, *Investigating the cultivation of diachronic sociolinguistic inherited discourses in Albanian Canons*, “De la unidad le lenguaje a la diversidad de las lenguas”. Actac del 10 Congreso Internacional de Linguística General. De la presente edicion, Universidad de Zaragoza, prima edicion, 2013, f. 474.

<sup>21</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 313.

<sup>22</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 321.

<sup>23</sup> I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*. Tiranë, 2006, f. 87.

Foljet në mënyrën urdhërore kanë përdorim të paktë si edhe mënyrat e tjera apo format e pashtjelluara.

Në nivelin e sintagmave në Kanunin e Labërisë gjejmë ndërtime me një emër prejfoljor dhe një emër në kallëzore ose në një rasë tjetër në rrjedhore me ose pa parafjalë: *të marrët e flokëve, të lidhurit me kumbari, zënie nuse, prerjen me gërshërë, fjalë-mirë a te prindja* etj.

Fjalitë e thjeshta janë kryesisht dëftore dhe dëshirore këto të fundit ndërtohen vetëm me folje të mënyrës dëshirore. Foljet në lidhore nuk përdoren për urim. Kjo veçori ka shtrirje më të gjerë se Labëria. *“Pasi jepet nishani të gjithë e urojnë: “Na u trashëgoftshin” Na qoftë e hairit miqësia, bukë e ëmbël dhe e pandarë, miqësi e pandarë. “Qofshi faqebardhë që më kini nderuar. Jua shpërblefsha në gëzime.”*<sup>24</sup> ndrikullës me urimin *“Rrofsh dhe e martofsh!”*

Shpesh herë zënë vend fjali emërore, ndeshen shumë gjymtyrë homogjene. *Marrja e nuses, çështje zakoni dhe nderi. Vëllamëri e pandarë. Babëzoti burri më i vjetër në moshë (stërgjysh, gjysh) më i zoti, i urtë, i mençur, burrë me dinjitet dhe i drejtë me të gjithë, pjesëtar i familjes.*<sup>25</sup>

Normat e komunikimit edhe për shprehjet e mençura, pavarësisht nga madhësia e formulimit përqaseshin me normat e sistemit shoqëror. Më kryesorja në komunikim i kushtojë parapëlqimit për krijimin e marrëdhënieve shoqërore. *“Kur komunikojmë ne nuk shkëmbejmë vetëm informacion, por njëkohësisht edhe hyjmë në marrëdhënie shoqërore. Për këtë arsye çdo shkëmbim informacioni është i përfshirë në proceset e të kuptuarit, të bashkëpunimit dhe interpretimit të ndërsjelltë të arsye të të vepruarit, qëllimeve, ligjërimeve dhe sjelljeve të pritshme”*<sup>26</sup>.

Kjo është edhe arsyeja e ndryshimit të kohëve të foljes në rast fatkeqësie. Fillohet fjalia me folje në urdhërore dhe vazhdohet me folje në dëshirore. Komunikimi ngushëllues realizohet më tej duke përdorur folje në lidhore. Shprehjet për ngushëllime dhe përgjigjet për to janë nga më të ndryshmet, sipas fshatit dhe personit. Në vdekje shumë të rënda të djalit të vetëm *“I zoti i shtëpisë ose një përfaqësues i tij u thotë: Merrni, qofshi faqebardhë, u ardhsha për të mira!”* dhe ata përgjigjen: *“Zoti të dhashtë durim! (sabër)”* Ata që vijnë për ngushëllim sipas shkallës së afritë së atij që ka vdekur sipas gjinisë dhe moshës shprehen: *“Të rroni vetë ose vetë shëndoshë”* apo *t'i rrojnë fëmijët*, ndërsa ata që presin ngushëllimet u përgjigjen sipas marrëdhënieve që kanë me ngushëlluesin: *“Shokët shëndoshë, Miqtë shëndoshë, Për të mira u ardhsha”*, etj.<sup>27</sup>

<sup>24</sup> I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*, Tiranë, 2006, f. 111.

<sup>25</sup> Po aty, f. 75, 89.

<sup>26</sup> Cituar sipas Gj. Shkurtaç, shih Albert Scherr, *Komunikation*, Schfers, 2000, f. 176.

<sup>27</sup> I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*, f. 109.

Ai që pi kafën thotë: “Për të mira këtej e tutje” ose *gëzime këtej e tutje*<sup>28</sup>.

Synohet për thënie të plota, parashatrojnë të gjitha anët të njiheshin në një vend, rrethanat në marrëdhëniet e tyre logjike. Fillimet e paragrafëve dalin me dy tipa mjaft të thjeshtë. Në të parin përsëriten të plota emërtimet ose kryefjalët e njëjta. “*Me dasmë kuptohet një ngjarje e jashtëzakonshme dhe e gëzueshme në jetën e njeriut që i jep karakter publik martesës dhe rrit ndjenjën e përgjegjësisë së të martuarve për bashkëjetesë, përpara njerëzve të tjerë. Ajo shënon marrjen e nuses me krushq e dasmorë nga shtëpia prindërore e saj në shtëpinë e dhëndërrit, si edhe gostinë (darka) që bëhet për të ftuarit.*”<sup>29</sup>

Ndërtimet e periudhave me lidhje të theksuara, vendosje saktë të përcaktorëve dhe gjymtyrëve të tjera kundrinor, rrethanor, me fjali përcaktore që shprehin marrëdhënie, nuanca të ndryshme. Priorja është përdorimi në periudha i të gjitha llojeve të fjalive me bashkërenditje dhe nënrenditje. Shumica e fjalive janë të shoqëruara me lidhëza.

“*Ikja e gruas së martuar nga burri në mënyrë të njëanshme, se trajtohet keq për në shtëpinë e babait të saj nuk lejohet, quhet turp i madh për familjen e burrit. Në këtë rast, çështja shtrohet me pleq të zakonit dhe si rregull, zgjidhet ose me kthim të gruas te burri duke kërkuar dorëzanë se nuk do të trajtohet keq, ose me vrasjen e babait ose vëllait të gruas, me prerjen e hundës a të veshit të saj. Gruaja që ikën nga burri dhe rrëmbehet prapë nga shtëpia e tij, si rregull i pritët hunda veshi ose veshët, e qethin fare, del nga ajo shtëpi dhe shoqërohet nga një djalë deri te dera e babës, ditën që ta shikojë i gjithë fshati.*”<sup>30</sup>

Krahas ndërtimeve me lidhëza të periudhave për të shprehur mendimet e mençura qartë për situatën dhe rastet e veçanta përdoren edhe periudha pa lidhëza ose fjalia e dytë është mungesore, por duke shprehur marrëdhënie të ndryshme:

“*Hyn nusja, del i vdekuri nga dera tjetër. Ngordhi kau, u prish parmenda. Jeta është shtatë jetë, guri i babës i vërtetë. Mbajtja e besës barazohej me burrërinë, me nderin dhe trimërinë “fjalë e dhënë, punë e bërë”. Besa ishte formë detyrimi për të ruajtur nderin, për t’u mos u veçuar.*”<sup>31</sup>

Përpjekja për të dhënë një mendim sa më të saktë, zakonisht, shoqërohet edhe me nevojën e krijimit të fjalëve të reja e të kuptimeve të reja, si edhe me formime të ndryshme para e prapashtesore p.sh. *burrëreshë, pamartuar, i pabesë, moslidhje*; të përngjitura: *ndërmjetës, shitblerje, besëlidhja, mospranim, hakmarrje*. Me shumë vlerë janë edhe shumë fjalë e shprehje

<sup>28</sup> I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*, Tiranë, 2006, f. 133.

<sup>29</sup> Po aty, f. 109.

<sup>30</sup> Po aty, f. 123.

<sup>31</sup> I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*, Tiranë, 2006, f. 147.

autoktone të kësaj krahine si: *treme* (fejesë me këmbim), *nishani* (unaza), *karthia* (dru të thata), *duvak* (kurore), *gjerdek* (oda e nuses), *mali belik* (prona shtetërore)

Pavarësisht mundësisë së rregullimit të kanuneve nga përgatitësit për botim, ata vlejné si dëshmi e tipareve fillestare të përshtatur në shekuj. Ligjërimet e pakodifikuara, e drejta zakonore ka karakter mbarëshqiptar e mbështetur në parimet kryesore të saj, shërben për thellimin dhe zgjerimin e lidhjeve shpirtërore, kulturore ekonomike dhe politike jo vetëm ndërmjet Jugut dhe Veriut, por edhe mes gjithë shqiptarëve. Evoluimin që ka bërë shoqëria në shekuj është shprehur me ndryshimin herë pas here jo vetëm në përmbajtje, por edhe në formë; në fillim si proverba, fjalë të urta të mençura: fjalë dhe thënie të urta të gdhendura si formula në ndërgjegjen e popullit u ruajtën dhe u trashëguan nga një brez në tjetrin, pastaj u shndërruan shkallë-shkallë në norma juridike që rregullonin marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike mes anëtarëve të katundeve dhe fshatrave territorialë.

Disa mjete të leksikut të përgjithshëm pësojnë ndryshime sidomos në përdorimet edhe si ndikim nga gjuhët e huaja, por edhe nga përpjekjet për shqipërim të një rregulli të përshtatur me kohën dhe me situatën. Shkrimi i kanunit në rrjedhë të shekujve është përgatitur më shumë në kohën e tashme, në tashmen historike me kuptimin e së shkuarës, duke e paraqitur si të gjallë një veprim që ka marrë fund në të shkuarën, sikur të ndodhë para syve tanë çdo ndryshim në rrjedhë të kohës. Foljet në lidhore nuk përdoren për urim. Sintagmat e fjalive kanë veçori të përbashkëta. Sintagma emërore është e pazgjeruar, ndërsa sintagma foljore është e zgjeruar edhe me sintagma të tjera. Fjalitë e thjeshta janë kryesisht dëftore dhe dëshirore. Këto të fundit ndërtohen vetëm me folje të mënyrës dëshirore.

Fjalitë si ndërtuese të periudhave dallohen për vendosje të saktë të përcaktoreve dhe gjymtyrëve të tjera: kundrinor, rrethanor etj. Prirja është përdorimi i periudhave të gjitha llojeve, të fjalive me bashkërenditje dhe nënrenditje. Shumica e fjalive janë të shoqëruara me lidhëza.

Vërehet ajo që kanë nënvizuar shkencëtarët socialë për rëndësinë e të dhënave gjuhësore për një kuptim dhe shpjegim më të mirë të disa dukurive shoqërore. Pikënisja e këtyre studimeve këndvështrohet tek bashkëvaracioni midis strukturës së sjelljes gjuhësore dhe strukturave sociale. Kultivimi i prirjeve pozitive në semantikë, morfologji, sintaksë në shekuj si shfaqje e kulturës së lashtë dhe të trashëguar shqiptare, janë kontribut për sociolinguistikën diakronike, vështruar kjo edhe tek Kanuni i Labërisë.

Kanuni i Labërisë është burim i vërtetë, një gurrë e pashtershme, ku gjuhëtari mund të gjejë lëndën e parë për punime e studime të mëtejshme. Pra normat e Kanunit të Labërisë janë të ndërtuara dhe të shkruara me shumë elegancë, me një shqipe të pastër e të pa ndikuar nga barbarizmat gjuhësore dhe vijné në ditët e sotme si vlerë gjuhësore. Kanuni i Labërisë është një

thesar i cili i ka rezistuar kohës dhe vjen në ditët e sotme si vlerë e shtuar e pasurisë tonë kombëtare.

#### **BIBLIOGRAFI**

- A. Kostallari, *Mbi shtrirjen e shtresëzimit e së drejtës kanunore në Shqipëri dhe mbi disa çështje që lidhen me studimin e saj e me organizimin e luftës kundër mbeturinave të së vjetrës*, “Etnografia shqiptare” IV, Tiranë, 1972.
- D. Klosi, Merkuri, N., *Investigating the cultivation of diachronic sociolinguistic inherited discourses in Albanian Canons*, “De la unidad le lenguaje a la diversidad de las lenguas”. Actac del 10 Congreso Internacional de Linguistica General. De la presente edicion, Universidad de Zaragoza, prima edicion, 2013.
- I. Elezi, *E drejta zakonore e Labërisë*, Toena, Tiranë, 2002.
- I. Elezi, *Kanuni i Labërisë*, Toena, Tiranë, 2006.
- Xh. Lloshi, *Dialekti përballë gjuhës letrare*, “Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës”, Tiranë, 1973.

# **GRAMATIKË DHE HISTORI GJUHE**

